



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr.03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes Për Ri-pranimin e Personave, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë, e nënshkruar në Prishtinë me datë 04 tetor 2011, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 19 tetor 2011.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-031-2011

Prishtinë, më 01 nëntor 2011



Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE

ndërmjet

Qeverisë së Republikës së Kosovës

dhe

Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë

për

Ri pranimin e Personave

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Mbretërisë së Suedisë, më tej "Palët",

Duke dëshiruar lehtësimin e ri pranimin apo transitin e personave që qëndrojnë pa autorizim në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese;

Duke marrë parasysh Konventën e datës 4 nëntor 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj shtesë, Konventën e datës 28 korrik 1951 mbi Statusin e Refugjatëve, e ndryshuar nga Protokollin e datës 31 janar 1967, Konventa mbi Reduktimin e pa shtetësisë së datës 30 gusht 1961,

Në frymën e bashkëpunimit dhe në bazë të reciprocitetit,

Duke respektuar detyrimet ndërkombëtare, në veçanti detyrimet në pajtueshmëri me të drejtën ndërkombëtare për të pranuar qytetarët e vet,

Janë pajtuar si në vijim:

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

- (a) “Shtetas i Kosovës” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Republikës së Kosovës në pajtueshmëri me legjislacionin e saj shtetëror;
- (b) “Shtetas i Suedisë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Mbretërisë së Suedisë, në pajtueshmëri me legjislacionin e saj kombëtar;
- (c) “Shtetas i vendit të tretë” do të thotë çdo person i cili mban një shtetësi tjetër nga ajo e Kosovës apo e Suedisë;
- (d) “Person pa shtetësi” do të thotë çdo person i cili nuk mban shtetësi të asnjë shteti;
- (e) “Leje qëndrimi” do të thotë leje e çdo lloji e lëshuar nga Kosova apo Suedia duke i dhënë të drejtë një personi që të qëndrojë në territorin e saj;
- (f) “Vizë” do të thotë autorizim i lëshuar ose një vendim i marrë nga Kosova ose Suedia e cila është e nevojshme për hyrje ose transit përmes territorit të saj. Kjo nuk përfshin vizat transit të aeroportit;
- (g) “Pala Kërkuese” do të thotë shteti (Kosova ose Suedia) që dorëzon një kërkesë për ri pranim në përputhje me nenin 4 të kësaj marrëveshjeje;
- (h) “Pala që i Kërkohet” do të thotë shteti (Kosova ose Suedia) të cilit i drejtohet kërkesa për ri pranim në përputhje me nenin 4 të kësaj marrëveshjeje;
- (i) “Autoriteti Kompetent” do të thotë cilido autoritet kombëtar i Kosovës ose Suedisë i ngarkuar me zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Lista e autoriteteve kompetente do të njoftohet përmes kanaleve diplomatike.
- (j) “Transit” do të thotë kalimi i një shtetasi të vendit të tretë ose personit të pa shtetësi përmes territorit të Palës që i Kërkohet përderisa udhëton nga Shteti Kërkues në vendin e destinacionit.

Neni 2

Ri pranimi i shtetaseve të tyre

1. Palët do të ripranojnë pa formalitete shtetasit e tyre të cilët nuk i përmbushin rregullat për hyrje në apo qëndrim në territorin e palës tjetër, me kusht që shtetësia është dëshmuar.
2. Nëse hetimet pasuese vërtetojnë se personi i ripranuar nuk ka përmbushur kushtet nga paragrafi 1, pala kërkuese do ta ripranojë atë person.
3. Paragrafi 2 nuk do të zbatohet nëse detyrimet tjera për ri pranim ekzistojnë në pajtueshmëri me këtë marrëveshje.

Neni 3

Ri pranimi i të huajve

1. Më kërkesë një palë do të ripranojë një shtetas të një vendi të tretë apo person pa shtetësi (i huaj), i cili nuk i përmbush rregullat për hyrje në apo qëndrim në territorin e palës tjetër. Ky obligim ekziston:
 - kur i huaji mban, ose në kohën e hyrjes ka mbajtur, një vizë të vlefshme apo leje qëndrimi të lëshuar nga pala që i kërkohet;
 - kur i huaji ka qëndruar në apo ka kaluar përmes territorit të palës që i kërkohet përpara hyrjes në territorin e palës kërkuese, me kusht që një vizë apo leje qëndrimi nuk është lëshuar nga pala kërkuese, apo
 - kur një shtetas i palës që i kërkohet është ripranuar, anëtarët e familjes duhet të ripranohen në mënyrë të barabartë, me kusht që ata kanë të drejtë ligjore sipas legjislacionit kombëtar për të marrë leje hyrje apo qëndrimi të asaj pale.
2. Nëse të dyja palët kanë lëshuar një vizë (për veç vizës transit) ose leje qëndrimi, përgjegjësia për ripranim duhet të qëndroj te pala që ka lëshuar vizën ose lejen e qëndrimit e cila skadon e fundit.

Neni 4
Procedurat dhe afatet kohore

1. Pala kërkuese, përveç nëse neni 2 është i zbatueshëm, do të dorëzojë kërkesën për ripranim tek autoriteti kompetente të palës që i kërkohet së bashku me informacione në dispozicion që mbështesin prova të shtetësisë, identitetit dhe origjinës ose ndonjë informacion tjetër relevant lidhur me personin që do të ripranohet. Një formë standarde e kërkesës për ri pranim e cila do të përdoret është e bashkangjitur.
2. Kërkesës për ripranim duhet t'i kthehet (përgjigje) sa më shpejtë që është e mundur por jo më larg se 28 ditë kalendarike. Nëse nuk ka përgjigje brenda këtij afati kohor, transferimi do të konsiderohet se është miratuar.
3. Pasi që pala që i kërkohet ka dhënë një përgjigje pozitive për kërkesën për ripranim, autoritetet kompetente të palës kërkuese do të lëshojnë dokumentin e udhëtimit të nevojshëm (për Kosovën një Dokument Udhëtimi për kthim për Suedinë një Dokument Standard Udhëtimi i BE-së,).
4. Një palë mund të kërkojë nga Misioni Diplomatik apo Konsullor palës që i kërkohet për të kryer një intervistë për të vërtetuar shtetësinë. Nëse shtetësia është vërtetuar autoritetet kompetente të palës kërkuese duhet të lëshojnë dokumentin e udhëtimit të kërkuar (për Kosovën një Dokument Udhëtimi për kthim për Suedinë një Dokument Standard Udhëtimi i BE-së,).
5. Pikat e kalimit kufitar të zgjedhura për zbatimin e kësaj marrëveshje janë në Republikën e Kosovës Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" dhe pikat e kalimit kufitar Hani i Elezit, Vërmicë, Kulla dhe Merdar dhe në Aeroportin Suedez Arlanda, Stokholm,

Neni 5
Bashkëpunimi direkt të mes të autoriteteve kompetente

1. Në mënyrë që të vërtetohet shtetësia, identiteti etj. në raste të veçanta për ripranim, autoriteti kompetent i njëjës palë mund të kërkojë një takim direkt në një pikë të kalimit kufitar të njëjës prej palëve.
2. Autoritetet kompetente të palëve do të bëjnë aranzhime paraprake për kohën dhe vendin e takimit dhe çështje të tjera relevante për takim, në pajtim me paragrafin 1.
3. Shpenzimet do të mbulohen nga pala kërkuese.

Neni 6
Dokumentet e udhëtimit për të huajt

Dokumentet e udhëtimit të kërkuara për ripranimin e të huajve janë një Dokument Udhëtimi për kthimin e të huajit i lëshuar nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës. dhe një Dokument Standard Udhëtimi i BE-së, i lëshuar nga autoritetet kompetente të Suedisë

Neni 7
Shpenzimet

Shpenzimet e transportit dhe shpenzime të tjera siç janë ushqimi, akomodimi etj për personin i cili do të ri pranohet, për procedurat e transiti në pajtim me nenin 8, ose ripranuar e gabuar në pajtim me nenin 2 do të mbulohen nga pala kërkuese deri në pikën e pranimit.

Neni 8
Transitit

1. Pala që i kërkohet, me kërkesë paraprake, do të lejojë një të huaj që do të kthehet të kalojë përmes territorit të saj me kusht që udhëtimi deri në shtetin e destinacionit është i siguruar. Në rast të tillë nuk kërkohet viza transit.
2. Nëse i huaji nuk është pranuar në shtetin e destinacionit ose nëse udhëtimi i mëtutjeshëm nuk është i siguruar pala kërkuese duhet ta ripranojë të huajin.
3. Transiti mund të refuzohet për shkak të rrezikimit të shëndetit publik, sigurisë kombëtare ose rendit publik.

Neni 9
Mbrojtja e të dhënave

- Informacionet e dorëzuara për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje do të përmbajnë vetëm të dhënat e nevojshme sa i përket identitetit, duke përfshirë dokumentet dhe të dhënat e tjera të personit që do të ripranohet dhe do të mbrohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve.

Neni 10
Të miturit e pashoqëruar

Palët do të sigurojnë objekte adekuate të pritjes në rast të ripranimit të të miturve të pashoqëruar, të cilët nuk mund të kthehen tek anëtarët e familjes së tij apo saj ose te kujdestari i caktuar.

Neni 11
Pezullimi

Pa paragjykim për detyrimin për ri pranimin e shtetasve të vet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, secila palë mundet përkohësisht të pezullojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Pezullimi do të njoftohet menjëherë në formë të shkruar tek pala tjetër dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë kalendarike pas datës së pranimit të njoftimit të tillë.

Neni 12
Klauzolat e pa prekshmërisë


1. Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të ndikoj në të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga dispozitat e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.
2. Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të pengoj kthimin e personit në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta formale dhe joformale.

Neni 13
Dispozitat përfundimtare


1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar.
2. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së pranimit të njoftimit të fundit me të cilat palët kanë njoftuar njëra tjetrën me shkrim se kërkesat e tyre përkatëse për hyrje në fuqi të marrëveshjes janë përfunduar.
3. Secila palë ka të drejtë në çdo kohë të denoncojë këtë marrëveshje duke njoftuar me shkrim palën tjetër përmes kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të pushoj së zbatuari 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.
4. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë marrëveshje mund të bëhen në çdo kohë përmes marrëveshjes me shkrim ndërmjet palëve. Ndryshimet dhe plotësimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafit 2.

E bërë në Prishtinë më 4th Oct në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, serbe, suedeze dhe angleze. Në rast të ndryshimeve në interpretim, versioni në gjuhën angleze do të mbizotëroj.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës



Për Qeverinë e Mbretërisë së Suedisë



Data

Nr. Ref.

Te

Kërkesë për Ripranim

Detaje personale

Emri, Emri i babait, Mbiemri	
Data dhe vendi i lindjes	
Llojet e dokumenteve të mbyllura	
Adresa në Kosovë / Suedi	

Data

Nr. Ref.

Te

Kërkesë për Ripranim

Detale personale

Emri, Emri i babait, Mbiemri			
Data dhe vendi i lindjes			
Llojet e dokumenteve të mbyllura			
Adresa në Kosovë / Suedi			
Fëmija 1 Emri, Emri i babait, Mbiemri		Data dhe vendi i lindjes	
Llojet e dokumenteve të mbyllura			
Fëmija 2 Emri, Emri i babait, Mbiemri		Data dhe vendi i lindjes	
Llojet e dokumenteve të mbyllura			
Fëmija 3 Emri, Emri i babait, Mbiemri		Data dhe vendi i lindjes	
Llojet e dokumenteve të mbyllura			
Fëmija 4 Emri, Emri i babait, Mbiemri		Data dhe vendi i lindjes	
Llojet e dokumenteve të mbyllura			
Fëmija 1	Fëmija 2	Fëmija 3	Fëmija 4